
Treguesit për caktimin e normës në % të shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC)

Në përputhje me rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” miratuar me vendimin nr.41, datë 05.06.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe udhëzimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik, për përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit përdoren treguesit e referencës. Këta tregues synojnë të reflektojnë në mënyrë sa më të drejtë ciklin e kreditimit dhe rreziqet që shoqërojnë rritjen e tepërt të kreditimit në vend, si edhe të konsiderojnë në mënyrë të përshtatshme specifikat e ekonomisë së vendit. Vlerat sasiore të treguesve janë gjithmonë subjekt i interpretimit dhe analizës së ekspertëve të cilët në analizë mund të përfshijnë edhe faktorë të tjerë cilësorë.

Midis treguesve të referencës, si *parësor* shërben “hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)”, që paraqet devijimin e vlerës aktuale të raportit “kredi për ekonominë / PBB” nga prirja e tij afatgjatë. Ky tregues sinjalizon mundësinë e rritjes së tepërt të kreditimit në raport me rritjen ekonomike dhe eventualisht rritjen e rreziqeve sistemike ciklike. Si *plotësues* të treguesit parësor, shërbejnë disa të tjerë të grupuar tek treguesi i paralajmërimit të hershëm (TPHP). Krahas treguesit parësor, ky përbëhet edhe nga pesë nëntregues të tjerë, që sinjalizojnë zhvillimet në kreditim dhe në aktivet jofinanciare (tregu i pasurive të paluajtshme).

Arsyetimi mbi caktimin e normës në % të KUNC

Tabelat në vijim paraqesin vlerat më të fundit të disponueshme të treguesve të përzgjedhur dhe mesataret historike përkatëse.

Nga tabela 1, vërehet që shifra e treguesit parësor rezulton në vlera të larta negative, larg vlerave të pragut krahasues që, si rregull, do të shoqërohej me rritjen e shtesës kundërciklike të kapitalitⁱ.

Tabelë 1: Treguesi parësor


Treguesi parësor ⁱⁱ	Mesatarja historike		T2-2019
	T4-2002 _ T4-2008	T1-2009 _ T1-2019	
<i>Hendeku i kredisë për ekonominë ndaj PBB-sëⁱⁱⁱ</i>	1.9 pp	-7.3 pp	-11.2 pp ^{iv}

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Sidoqoftë gjatë T2-2019 është përshpejtuar ritmi vjetor i rritjes së kredisë për ekonominë e ndikuar si nga kredia për individët ashtu edhe nga ajo për ndërmarrjet rezidente. Kjo ecuri

ka ndikuar në ngushtimin e vlerave negative të treguesit parësor gjatë vitit të fundit, siç vërehet nga grafiku.

Grafik: Ecuria e hendekut të raportit “Kredi për ekonominë / PBB” në pikë përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabela 2 e treguesve plotësues, tregon për një rritje vjetore të kredisë bankare për pasuri të paluajtshme dhe, njëherazi, një rritje vjetore të indeksit të çmimit të banesave. Është e rëndësishme që ecuria e këtyre dy treguesve, të cilët prirën të përforcojnë ecurinë e njëri-tjetrit, të monitorohet në vijimësi. Qëllimi është që, duke përdorur edhe informacionet që lidhen me ngarkesën me borxh të familjeve, të identifikohen dhe parandalohen situatat në të cilat ecuria e çmimeve në tregun e pasurive të paluajtshme është e paqëndrueshme.

Tabelë 2: Treguesit plotësues

Treguesit plotësues ^v	Mesatarja historike (T4-2002 _ T1-2019)	T2-2019
Intensiteti i kredisë për ekonominë ^{vi}	3.1%	-0.3%
Ndryshimi vjetor i kredisë bankare për pasuri të paluajtshme	23.3%	3.3%
Ndryshimi vjetor i indeksit të “çmim i banesave / vlera e qirasë” ^{vii}	7.7%	2.4%
Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimit të banesave	3.7%	4.6% ^{viii}
Rritja vjetore e kredisë bankare ^{ix}	17.7%	-3.5%

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Mbështetur në të dhënat dhe analizën e treguesve të mësipërm, vlerësohet se rreziqet që lidhen me kreditimin e tepërt nuk janë aktualisht të rëndësishëm. Si rezultat norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë, propozohet të vijojë të jetë 0%.

SQARIME:

ⁱ Rritja e shtesës kundërciklike të kapitalit mund të jetë e nevojshme edhe nëse vlerat e treguesit parësor janë më të vogla se pragu krahasues. Ky është rasti kur, pavarësisht ecurisë së kredisë në përgjithësi, vërehen zhvillime të shpejta të kreditimit në sektorë të caktuar, të cilat konsiderohen të paqëndrueshme dhe burim rreziku për qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe të tregjeve.

ⁱⁱ Në analizën e vlerave në tabelë, duhet konsideruar që vlerat e llogaritura të treguesit parësor dhe të mesatares së tij historike, ndryshojnë për shkak të dy grupeve të faktorëve: a) zhvillimeve në vlerat e kredisë për ekonominë dhe të PBB-së; dhe b) rishikimeve të vlerave të PBB-së që kryen rregullisht Instituti i Statistikave (INSTAT). Këto dy grupe faktorësh mund të ndikojnë mbi vlerën e treguesit parësor, në të njëjtin kah ose në kahe të ndryshme. Më konkretisht, vlera e llogaritur e treguesit parësor në T1-2019, e publikuar në 28.06.2019 si pjesë e kësaj analize, ishte -11.1%. Pas publikimit të vlerës së PBB-së nga INSTAT dhe rishikimeve të serisë, vlera e treguesit parësor në atë periudhë rezultoi -11.6%.

ⁱⁱⁱ Vlera e PBB-së është llogaritur si shuma e vlerave të katër tremujorëve të fundit.

^{iv} Vlera e treguesit parësor për T2-2019 në -11.2% shënon një ngushtim (përmirësim) të hendekut të kredisë në krahasim me vlerën e rishikuar të T1-2019. Në këtë ndryshim ka ndikuar rritja e kredisë për ekonominë gjatë T2 me një ritëm më të shpejtë se rritja e PBB-së.

^v Këta tregues, së bashku me treguesin parësor, përbëjnë “Treguesi i Paralajmërimit të Hershëm Plotësues”.

^{vi} Vlera absolute e rritjes vjetore të kredisë për ekonominë si raport ndaj vlerës së vjetorizuar të PBB-së (shuma e vlerave të PBB-së për katër tremujorët e fundit).

^{vii} Vlerat e indeksit zbuten për 8 tremujorët e fundit.

^{viii} Vlerat e indeksit zbuten për 8 tremujorët e fundit. Në T2-2019, metodologjia e ndërtimit të indeksit ka ndryshuar duke sjellë edhe ndryshimin e vlerës mesatare historike të tij.

^{ix} I referohet totalit të kredisë së dhënë nga sektori bankar për sektorin publik dhe atë privat jofinanciar.